



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr.1470/7 Prot

Tiranë, më 08.11.2023

VENDIM

Nr.51, datë 08.11.2023

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesja znj. \_\_\_\_\_, gazetare pranë “Amfora.al” (në vijim “ankuesja”), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1470 Prot., datë 08.09.2023, saktësuar me e-mail-in datë 13.09.2023, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesja, në cilësinë e kërkueses, nëpërmjet kërkesës datë 28.07.2023, depozituar në adresën elektronike [info@iktk.gov.al](mailto:info@iktk.gov.al), ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni në lidhje me:

1. Cilat janë gjetjet arkeologjike, monumentet e kulturës apo evidencat e ngjashme të zbuluara para dhe pas zbatimit të projektit në gjurmën ku ai shtrihet?
2. Lidhur me zbulimin e objektit me karakter arkeologjik, i identifikuar si “Muri i Demës”, më vendosni në dispozicion raportin e Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik, të hartuar në vitin e zbulimit të tij;
3. Më vendosni në dispozicion proces-verbalet e çdo mbledhje të ish-Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë për zbulimet që lidhen me objektin me karakter arkeologjik, të identifikuar si “Muri i Demës”, në kohën kur ai u zbulua;
4. Kur është paraqitur pranë Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM) për vlerësim projekti “Jonian Heaven”?
5. Më vendosni në dispozicion të gjitha vendimet e KKMTS-së për këtë projekt;
6. Më vendosni në dispozicion proces-verbalet e çdo mbledhje të KKMTS-së për këtë projekt;

7. Lidhur me zbatimin e projektit më vendosni në dispozicion të gjitha dokumentet, përfshirë projektin teknik, detajet e tjera teknike, studimet dhe çdo dokument të ngjashëm, të dorëzuar pranë jush;
8. A është lidhur akt-marrëveshja tre palëshe me një subjekt privat të licensuar në arkeologji për monitorimin e punimeve? - Nëse po, më vendosni në dispozicion një kopje të akt-marrëveshjes;
9. A janë kontrolluar nga ana juaj këto punime?
10. Nëse po, na informoni për rezultatet e tyre;
11. A ka pasur gjetje arkeologjike përgjatë zbatimit të projektit?
12. Nëse po, na informoni për rezultatet e tyre;
13. Si është vepruar gjatë zbatimit të projektit me gjetjet arkeologjike, më konkretisht me objektet me karakter arkeologjik, të identifikuara si "Muri i Demës",
14. Cili është raporti i këtij projekti, gjurma dhe zhvillimi i tij në raport me Monumentin e Kulturës, "Manastiri i Shën Gjergjit"?
15. A janë bërë vlerësime për ndikimin e monumentit nga projekti?
16. Nëse keni informacion, a janë zhvilluar dëgjesa publike me grupet e interesit për këtë projekt?
17. Nëse po, na informoni më në detaje mbi to.

Pas përgjigjes së Autoritetit Publik, nëpërmjet e-mail-it datë 10.08.2023, ankuesja me pretendimin se nuk ka marrë informacionin për pikat 3, 6 dhe 7 të kërkesës për informacion, i është drejtuar Komisionerit me ankesë, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e autoritetit publik për dhënien e informacionit të kërkuar.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" i ndryshuar, (në vijim "LDI").

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: "*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*", Zyra e Komisionerit, me shkresën nr. 1470/1 prot., datë 13.09.2023, ka kërkuar nga Autoriteti Publik qëndrimin lidhur me pretendimin e ngritur nga ankuesja, si dhe sqarime për zotërimin e informacionit/dokumentacionit të kërkuar, duke rivlerësuar në këtë mënyrë kërkesën për informacion, brenda datës 20.09.2023.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 1111/1 Prot., datë 19.09.2023, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1470/2 Prot., datë 20.09.2023, ka kthyer përgjigje duke sqaruar në lidhje me procedurën e ndjekur të kërkesës/ankesës, si dhe duke argumentuar në vijim se: "*... Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga neni 7, pika 1 e Ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", IKTK ka publikuar në faqen e internetit <https://iktk.gov.al/site/informacionin publik mbi veprimtarinë e institucionit>. Në faqen e internetit janë bërë publike edhe ato kategori informacioni, të cilat sipas gërmës "", të pikës 1, neni 7 i ligjit Nr. 119/2014, vlerësohen nga autoriteti publik si informacione të dobishme për t'u*

aksesuar nga publiku. Fryma që ndjekë neni 7 i Ligjit Nr. 119/2014, ka të bëjë me publikimin e akteve të miratuara nga ana e autoritetit publik. - Ligji Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", në nenin 17 të tij, parashikon rastet kur e drejta e informimit kufizohet nëse dëmtohen interesat që lidhen me sekretin tregtar dhe të drejtën e autorit. Në lidhje me pikën 1 të nenit 17 të Ligjit Nr. 119/2014, sqarojmë se, aplikuesi dhe zhvilluesi i projektit "Jonian Heaven është subjekt privat. Në këto kushte, IKTK e ka të pamundur vënien në dispozicion të procesverbaleve të mbledhjeve mbi projektet e sipërcituara. Për më tepër, procesverbalet e mbledhjeve të KKTKM-së janë të një natyre të diskutimit paraprak midis anëtarëve mbi vendimmarrjen. IKTK bënë publik, nga ana formale, aktin e miratuar në KKTKM, i cili në rastin konkret është Vendimi Nr. 271, datë 08.06.2021. - Me qëllim realizimin e të drejtës për informim, sipas nenit 3 të Ligjit Nr. 119/2014, ligjvënësi është treguar i kujdesshëm duke parashikuar një klauzol brenda rasteve të kufizimit sipas pikës 1 të nenit 17, ku citohet se "informacioni i kërkuar nuk refuzohet në rast se ekziston një interes publik më lartë për dhënien e tij". Pra, ky përjashtim nga rregulli i përgjithshëm mbi rastet e kufizimit, zbatohet kur përmbushet kushti i vendosur në ligj që është ekzistenca e interesit publik më të lartë në dhënien e këtij informacioni.

Në këkesën e datës 22.08.2023, znj. Azizolli nuk ka dhënë argumente bindëse mbi përcaktimin e interesit publik më të lartë, i cili përcaktohet si përjashtim në dhënien e informacionit, sipas pikës 1, neni 17 i ligjit të sipërcituar. Subjekti ankues, në lidhje me këtë çështje, është shprehur vetëm se "ka qëllime gazetareske të cilat përfaqësojnë interesin publik", por pa sjellë fakte dhe argumente ligjore që lidhin kërkimet e saj si gazetare. Për këtë arsye, IKTK i kërkon subjektit ankues të depozitojë një relacion shpjegues mbi kërkesën e informacionit dhe lidhjen e ekzistencës së interesit publik në raport me këtë kërkesë ”.

Ankuesja, pas përgjigjes së sipërcituar të Autoritetit Publik, ka vijuar ankimin pranë Zyrës së Komisionerit regjistruar me nr. 1470/3 Prot., datë 25.09.2023, duke argumentuar ndër të tjera se: Lidhur me citimin si, "subjekt privat", saktësojmë se kemi të bëjmë me rastin kur ky projekt është transparent dhe i është dedikuar një vendim i posaçëm i qeverisë shqiptare. Sipas Vendimit NR. 8/6 DATË 02/12/2021 të Komitetit të Investimeve Strategjike, u miratua statusi "Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Asistuar", për projektin e investimit "Manastir Resort - Resort Turistik 2, 3 dhe 4 kate me parkime nëntokë". Ashtu siç unë do e bashkëlidh, të gjitha të dhënat e aplikuesit, kompanisë, detajet e sipërfaqeve të ndërtimit, kateve, zonës etj., janë bërë publike në këtë vendim dhe të tjera të lidhura me të. Qartësisht Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore po përdor standard të dyfishtë dhe që në përgjigjen e tij zyrtare shkel në mënyrë të hapur Ligjin për të Drejtën e Informimit, kjo bazuar në fakte mbi praktika të trajtuara nga Autoriteti Publik mbi projekte me investitor privat dhe shtetëror.

Lidhur me argumentin mbi proseverbalet e mbledhjeve saktësoj sipas Ligjit "Për të Drejtën e Informimit", në Nenin 2, pika 2: "Informacion public" është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti public". Në këtë linjë, është jo korrekte që proces-verbalet të trajtohen me 2 standarde nga ana e IKTKsë, ku sipas tyre dallojnë proces-verbalet e terrenit (të vendosur në dispozicion në të kaluarën për Median

*Amfora) dhe të mbledhjeve të këshillit shkencor. Në çdo rast ai mbetet një dokument publik i cili krijohet nga autoriteti sipas detyrimeve ligjore që rrjedhin nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 364, datë 29.05.2019, "Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së institutit kombëtar të trashëgimisë kulturore" dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 208, datë 10.04.2019, "Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të këshillit kombëtar të trashëgimisë kulturore materiale", Pika III. "Funksionimi i këshillit": "I. KKTKM-ja mbledhet jo më pak se një herë në 2 muaj. Mbledhjet e këshillit thirren nga kryetari dhe njoftimi përcillet nga sekretaria teknike, të paktën, 3 ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen. Në raste të vecanta, mbledhja mbahet edhe në një ditë të ndryshme nga ai i njoftimit, kur janë të pranishëm të gjithë anëtarët dhe miratojnë, paraprakisht, zhvillimin e mbledhjes. Vendimi reflektohet në procesverbalin e mbledhjes".*

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", në të cilin parashikohet se: "...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve", bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", me shkresën nr. 1470/4 Prot., datë 06.10.2023, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore.

Seanca u zhvillua me prezencën e ankueses dhe përfaqësuesve të Autoritetit Publik. Gjatë seancës dëgjimore, ankuesja rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesë. Gjithashtu, përfaqësuesit e Autoritetit Publik mbajtën qëndrimin e reflektuar në përgjigjet e sipërcituara, duke theksuar ndër të tjera se në lidhje me informacionin mbi zbatimin e projektit "Jonian Heaven, i gjithë dokumentacioni, projekti teknik, studimet e çdo dokument tjetër, bazuar në nenin 17, pika 1 e LDI, dhënia e informacionit kufizohet kur dëmtohen interesa ...c) të drejtën e autorit si dhe ligjit 35/2016 "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me to" neni 21 (pika 1 dhe 2)".

Pas seancës dëgjimore, me e-mail-in datë 25.10.2023, ankuesja ka vijuar ankimin duke kërkuar urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e informacionit/dokumentacionit për pikat 6 dhe 7 të kërkesës për informacion, konkretisht:

- *Procesverbalet për dy mbledhjet ku janë marrë vendimet nr. 75, datë 27.0.2010 dhe nr.271, datë 08.06.2021;*
- *Lidhur me zbatimin e projektit vendosni në dispozicion të gjitha dokumentet, përfshirë projektin teknik, detajet e tjera teknike, studimet dhe çdo dokument të ngjashëm, të dorëzuar pranë jush.*

Pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik, nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI.

Bazuar në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”*.

Në kuptim të këtij parashikimi, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në nenin 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike”*.

Në lidhje me qëndrimin e ngritur nga Autoriteti Publik se: *“... IKTK e ka të pamundur vënien në dispozicion të procesverbaleve të mbledhjeve mbi projektet e sipërcituara, pasi aplikuesi dhe zhvilluesi i projektit “Jonian Heaven është subjekt privat, ndaj e drejta e informimit kufizohet nëse dëmtohen interesat që lidhen me sekretin tregtar dhe të drejtën e autorit sipas nenit 17 të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Komisioneri vlerëson se ky argument nuk qëndron.*

Konstatohet se, Autoriteti Publik në argumentin e parashtruar për mos dhënie të informacionit nuk ka dokumentuar/provuar ekzistencën e këtyre dy të drejtave.

Po ashtu Autoriteti Publik nuk ka bërë një analizë të mirëfilltë apo të argumentojë se si e drejta për informim kufizohet kur është e domosdoshme, propocionale si dhe dëmin që mund t’u shkaktojë palëve mbi sekretin tregtar dhe të drejtën e autorit, si pasojë e vendosjes në dispozicion të procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale.

Bazuar në pikën III “Funksionimi i këshillit” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.208, datë 10.04.2019, *“Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve të këshillit kombëtar të trashëgimisë kulturore material”,* përcaktohet se *“I. KKTKM-ja mblidhet jo më pak se një herë në 2 muaj. Mbledhjet e këshillit thirren nga kryetari dhe njoftimi përcillet nga sekretaria teknike, të paktën, 3 ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen. Në raste të vecanta, mbledhja mbahet edhe në një ditë të ndryshme nga ai i njoftimit, kur janë të pranishëm të gjithë anëtarët dhe miratojnë, paraprakisht, zhvillimin e mbledhjes. Vendimi reflektohet në procesverbalin e mbledhjes”*. Në këtë kuptim procesverbalet e mbledhjeve të cilat janë pjesë detyruese që shoqërojnë Vendimin e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, përpilohen/disponohen nga Autoriteti Publik, përbëjnë informacion publik në kuptim të pikës 2, të nenit 2, të LDI, në të cilën parashikohet se *“Informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”*. Rrjedhimisht ky i fundit ka detyrimin të vendosë në dispozicion informacionin e kërkuar.



Referuar pretendimit të Autoritetit Publik se: “...mbi zbatimin e projektit “Jonian Heaven, i gjithë dokumentacioni, projekti teknik, studimet e çdo dokument tjetër, bazuar në nenin 17, pika 1 e LDI, dhënia e informacionit kufizohet kur dëmtohen interesa ...c) të drejtën e autorit si dhe ligjit 35/2016 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me to” neni 21 (pika 1 dhe 2)”, Komisioneri vlerëson se ky argument nuk qëndron, pasi gjatë hetimit administrativ të çështjes Autoriteti Publik nuk paraqiti asnjë provë lidhur me pretendimin e ekzistencës së të drejtave të mbrojtura të autorit në përputhje me dispozitat e ligjore të sipërcituara. Megjithatë, edhe nëse do të provohej ekzistenca e të drejtave të mbrojtura të autorit mbi informacionin/dokumentacionin e kërkuar, në bazë të nenit 78 të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, “Veprat me të drejtë autori do të lejohen të riprodhohen dhe të përcillen për publikun, për rastet konkrete, pa autorizimin e autorit ose të titullarit të së drejtës së autorit dhe pa shpërblim, për kryerjen e detyrave që lidhen me sigurinë publike, për përdorimin dhe kryerjen e procedurave gjyqësore, administrative, parlamentare dhe procedurave në arbitrazh, përveçse në rastin e përmbledhjeve”. Në këtë kuptim, veprat me të drejtë autori do të lejohen të riprodhohen dhe të përcillen për publikun, për rastet konkrete, pa autorizimin e autorit ose të titullarit të së drejtës së autorit dhe pa shpërblim, për përdorimin dhe kryerjen e procedurave administrative si në rastin konkret. Nga ana tjetër, në parim kërkesat e ankueses për t’u informuar nuk çenojnë apo zhveshin autorin nga të drejtat e njohura me ligjin e posaçëm, si dhe mekanizmat që ky ligj i vë në dispozicion autorit dhe/ose mbajtësit të së drejtës për të mbrojtur apo gëzuar atë.

Në rastin konkret kërkesa për informacion lidhet me investime strategjike në fushën e turizmit, të cilat bazuar në nenin 1 të ligjit nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, ka për qëllim nxitjen dhe tërheqjen e investimeve strategjike, vendase dhe të huaja, në sektorët e ekonomisë, të identifikuar prej këtij ligji si sektorë strategjikë, nëpërmjet vendosjes së procedurave të posaçme administrative favorizuese, lehtësuese apo përshpejtuese të mbështetjes e të shërbimeve ndaj investitorëve.

Po ashtu, bazuar në nenin 5 “Interesi publik” të ligjit të sipërcituar përcaktohet se: “Investimet strategjike, të përcaktuara si të tilla në këtë ligj, konsiderohen me interes publik. Përcaktimi i interesit publik në përzgjedhjen e një investimi strategjik vlerësohet sipas:

- a) vlerës së investimit;
- b) kohës së realizimit të investimit;
- c) produktivitetit dhe vlerës së shtuar të investimit;
- ç) hapjes së vendeve të reja të punës;
- d) prioritetit ekonomik sektorial;
- dh) zhvillimit ekonomik rajonal dhe lokal;
- e) zhvillimit apo përmirësimit të kushteve dhe standardeve për prodhimin e mallrave dhe ofrimin e shërbimeve;
- ë) ofrimit të teknologjive të reja për të rritur konkurrencën dhe efektivitetin e investimit;
- f) rritjes së nivelit të përgjithshëm të sigurisë dhe cilësisë së jetës së qytetarëve;
- g) mbrojtjes së mjedisit dhe konsumatorit”.

Bazuar në sa më sipër, si dhe të *Vendimit nr. 8/6 datë 02/12/2021 të Komitetit të Investimeve Strategjike, në të cilën është miratuar statusi “Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Asistuar”*, për projektin e investimit *“Manastir Resort - Resort Turistik 2, 3 dhe 4 kate me parkime nëntokë”*, rrjedhimisht edhe interesi i publikut për të aksesuar në informacion është i drejtëpërdrejtë dhe i lartë.

Pavarësisht sa më sipër, në çdo rast, Autoriteti Publik duhet të kishte argumentuar moszbatimin e parashikimit në paragrafin e fundit të pikës 1 të nenit 17 të LDI, sipas të cilit informacioni i kërkuar nuk refuzohet në rast se ekziston një interes publik më i lartë për dhënien e tij. Duke qene se informacioni i kërkuar paraqet interes për publikun, rrjedhimisht, ky dokumentacion, duhet të ishte bërë publik duke garantuar kështu njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për sa i përket pretendimit të Autoritetit Publik se: *“... IKTK i kërkon subjektit ankues të depozitojë një relacion shpjegues mbi kërkesën e informacionit dhe lidhjen e ekzistencës së interesit publik në raport me këtë kërkesë”*, Komisioneri vlerëson se ky pretendim nuk qëndron, pasi bazuar në pikën 1 të nenit 3 të LDI përcaktohet qartë se: *“Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacion publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet”*, rrjedhimisht, duke përjashtuar kërkesen, në këtë kuptim të shpjegojë arsyet dhe motivet e kërkit.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, dokumentacioni i kërkuar, në parim përbën informacion publik bazuar në pikën 2, të nenit 2, të LDI sipas të cilës: *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”*. Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse është prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar në formën e zotëruar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të këtij ligji, i cili parashikon: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike. Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e LDI parashikon se: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

Gjithashtu, kërkesja/ankuesja është gazetare, e cila synon informimin e opinionit publik mbi çështje lidhur me funksionimin e autoriteteve publike, duke i shërbyer në këtë mënyrë interesit të lartë publik. Ky qëndrim i Komisionerit, gjen mbështetje në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila në çështjen *“Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë”*, vlerësoi se, pengesat e krijuara, të cilat vështirësojnë aksesin në informacion me interes publik, mund të dekurajojnë punonjësit e medias ose në fusha të ndërlidhura me të, të

realizojnë punën e “mbikqyrësit shoqërorë”, duke zvogëluar mundësitë e tyre për të ofruar informata të sakta dhe të besueshme.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksonimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

## **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në shkronjat b), c) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 10 dhe 12 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

## **V E N D O S A:**

1. Pranimin e ankesës nr. 1470 Prot., datë 08.09.2023, saktësuar me e-mail-in datë 13.09.2023, nga znj. \_\_\_\_\_, kundër Autoritetit Publik “Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore”, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas pikës 6 dhe 7 të kërkesës për informacion datë 28.07.2023, konkretisht: (“6).*Procesverbalet për dy mbledhjet ku janë marrë vendimet nr. 75, datë 27.0.2010 dhe nr.271, datë 08.06.2021; 7.) Lidhur me zbatimin e projektit vendosni në dispozicion të gjitha dokumentet, përfshirë projektin teknik, detajet e tjera teknike, studimet dhe çdo dokument të ngjashëm, të dorëzuar pranë jush*”), duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, brenda datës 16.11.2023.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 08.11.2023.

## **KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**